



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Kuvendi i Komunës Rahovec



Opština Skupština Račvoće/Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01123 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 47

Data/Datum/Date 30/03/2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK), Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2023, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për këmbimin e pronës komunale me pronën institucionit qendror

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, Nr. 02/266/23, i datës 8.3.2023 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Ravne shume, zona kadastrale Rahovec, parcela me numër P-71510057-02302-0, sipas Certifikatës së pronësisë - pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 2261m<sup>2</sup> (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 199774m<sup>2</sup> (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër metra katror), **I JEPET** në posedim Org. Punuese Sharri (Pylltaria), ndërsa parcela sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-02172-1, në posedim të Org. Punuese Sharri (Pylltaria), me sipërfaqe të përgjithshme prej 2261m<sup>2</sup> (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror), **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për ndërtimin e një mjedisi (parku) rekreativ, i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është për interes publik, përkatësisht për ndërtimin e një mjedisi (parku) rekreativ, i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
3. OBLIGOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe i pronës së institucionit qendror, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.

5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar me përmbytjen e të dhënave të pronave të këmbyerë, si dhe emrin e pronarit të institucionit qendror me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- **Anëtarëve të Kuvendit,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.47/23**  
**Me datë:30.03.2023**

